




European
Union
Kosovo

Vëzhgimi i orës mësimore

Projekti: “Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve”
Zbatuar nga: **Planet, Sofreco dhe WUS Austria**



Përmbajtja

Hyrje	2
Vëzhgimi në klasë si gurthemel për zhvillimin profesional të mësimeve	3
Kërkesat kryesore për vëzhgimin e orës mësimore	4
Procesi i vëzhgimit të orës mësimore	5
4.1. Takimi para vëzhgimit	5
4.2. Mbledhja e provave	6
4.3. Interpretimi i provave	6
4.4. Takimi pas vëzhgimit	7
Vëzhgimi ndërmjet kolegëve	8
Dokumente dhe linqe për materiale	10
Shtojca 1: Rast studimor - Përvoja e një ekipi mësuesish të detyruar të marrin pjesë në mentorim grupor të kolegëve në një shkollë të mesme suedeze	11
Përmbledhje e diskutimit pas vëzhgimit	17

Hyrje

Megjithëse zakonisht pak mësimdhënës synojnë të përmirësohen, shumica e tyre mund ta forcojnë performancën e tyre. Në fakt, për shkak se mësimdhënësia kërkon shumë punë dhe është e ndërlikuar, çdoherë mund të përmirësohet; pa marrë parasysh sa e shkëlqyeshme është një orë mësimore, ajo gjithmonë mund të përmirësohet. Dhe nëse nuk e përdorim procesin e vëzhgimit për atë qëllim, është e drejtë të pyesim pse mësimdhënësit përfshihen në të.

Një përkufizim i mësimdhënies që i përgjigjet kushteve gjithmonë në zhvillim në klasë do të shtrojë sfida të ndryshme për vëzhguesit / mentorët.

Një mjedis dinamik në të cilin aspektet e mësimdhënies konsiderohen të rëndësishme për mësimnxënien e nxënësve dhe për një lloj të veçantë të mësimnxënies së nxënësve - domethënë, është ai mjedis ku aftësitë e nivelit të lartë zhvillohen me kalimin e kohës.

Vëzhguesi / mentori duhet të jetë i vetëdijshëm se pritjet e mësimdhënësve që punojnë me një kurrikulë të re, të përshtatshme për Shekullin e 21, theksojnë aftësitë e arsytimit dhe zgjidhjes së problemeve, si dhe zhvillimin e të kuptuarit të thellë konceptual, i cili ka rrjedhoja të drejtpërdrejta në strategjitë e mësimdhënies.

Secili element individual i një sistemi efektiv të zhvillimit profesional duhet të shoqërohet me përmirësimin e mësimnxënies së nxënësve. Kjo do të thotë se nivelet e larta të performancës së mësimdhënësve në lidhje me Kornizën Strategjike të Mësimdhënies në Kosovë si tërësi duhet të parashikojnë nivele të larta të të nxënësve.

1.1 Qëllimi i Modulit

Ky modul ka për qëllim që t'i udhëzojë pjesëmarrësit nëpër hapat e procesit të vëzhgimit të orës mësimore, nga takimi para vëzhgimit deri te diskutimi pas vëzhgimit. Përqendrohet në elementet kryesore të takimeve para dhe pas vëzhgimit dhe në proceset e mbledhjes dhe interpretimit të provave. Moduli synon zhvillimin e aftësive të mentorëve për të përdorur në mënyrë efektive vëzhgimin e orës mësimore për identifikimin e nevojave për ZHPM dhe për përmirësimin / avancimin e praktikave mësimore. Moduli u mundëson pjesëmarrësve:

- Ta kuptojnë rëndësinë dhe natyrën e vëzhgimit të orës mësimore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.
- Të reflektojnë lidhur me sfidat e mundshme për përdorimin e vëzhgimit të orës mësimore dhe për t'i identifikuar zgjidhjet e mundshme.
- Ta udhëheqin si duhet një takim para vëzhgimit.
- Të zhvillojnë aftësi për të mbledhur prova gjatë vëzhgimit të orës mësimore dhe t'i interpretojnë ato prova.
- T'i identifikojnë pikat e forta dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim.
- Ta lehtësojnë si duhet një takim pas vëzhgimit.
- Ta inicojnë dhe mbështesin procesin e vëzhgimit të kolegëve në nivelin e shkollës.

1.2 Si të përdoret ky Modul

Përmbajtja e këtij moduli mund të përdoret si pjesë e punës përgatitore të trajnerëve për planifikimin dhe ofrimin e trajnimit për mentorët me bazë në shkollë. Burimet, sugjerimet dhe mjetet që janë pjesë e përmbajtjes së tij kanë për qëllim gjithashtu t'i mbështesin mentorët gjatë përvojës së tyre të mentorimit. Prandaj duhet t'u shpërndahet pjesëmarrësve në trajnim, për t'i udhëzuar gjatë punës së tyre drejt zhvillimit profesional të mësimitdhënësve.

Vëzhgimi në klasë si gurthemel për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve

Në fakt ata e bëjnë dallimin midis të mësuarit të suksesshëm dhe të pasuksesshëm. Shumica e hulumtimeve në arsim, e veçanërisht ato nga eksperti i njohur i arsimit në Australi, John Hattie, theksojnë se faktori i vetëm më i rëndësishëm në arritjet e nxënësve është cilësia e mësimitdhënies. Profesionalizmi shembullor i një mësimitdhënësi të mirë mund të bëjë ndryshimin mes ekuivalentit të shkollimit dy vjeçar shtesë për nxënësit e tyre, krahasuar me përpjekjet e një mësimitdhënësi të dobët.

Mësimitdhënia në klasë ndihmohet me shumë planifikim dhe punë përgatitore, por megjithatë, ajo që ndodh në klasë është në fakt pjesa kryesore e mësimitdhënies. Pavarësisht se sa i aftë të jetë një mësimitdhënës në aspektet e tjera të mësimitdhënies - të tilla si planifikimi i kujdesshëm, puna e mirë me kolegët dhe komunikimi me prindërit, nëse praktika në klasë është e mangët, atëherë ai individ nuk mund të konsiderohet mësimitdhënës i mirë.

Prandaj, vëzhgimi në klasë është aspekt thelbësor për t'i identifikuar nevojat e mësimitdhënësve për zhvillim profesional dhe për t'i avancuar proceset e mësimitdhënies dhe mësimitnxënies.



Kërkesat kryesore

Një përkufizim i qëndrueshëm i mësimdhënies së mirë. Për ta vlerësuar cilësinë e praktikës mësimdhënëse, është thelbësore ta përkufizoni atë.

Nuk është e mjaftueshme të thuash, "Unë nuk mund ta përkufizoj mësimdhënien e mirë, por mund ta dalloj kur e shoh." Si referencë kryesore për vëzhgimin e orës mësimore që ka për qëllim ZHPM-në duhet të shërbejë Korniza për Sigurimin e Cilësisë së Performancës së Shkollës. Mësimdhënia dhe mësimnxënia është një nga pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës, e përshkruar në dokument përmes pesë kritereve të vlerësimit dhe treguesve përkatës. Dokumenti tjetër referues është Korniza e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve që përcakton standardet e performancës së mësimdhënësve.

Një kuptim i përbashkët i këtij përkufizimi: I gjithë sistemi - mësimdhënësit, mentorët, trajnerët dhe mbikëqyrësit - duhet të kenë një kuptim të përbashkët të këtij përkufizimi. Të kesh një gjuhë të përbashkët për ta përshkruar praktikën e rrit vlerën e bisedave që vijnë nga vëzhgimet në klasë. Për shembull, diskutimi për "angazhimin e studentëve në mësimnxënie" është më efektiv kur të gjithë e kuptojnë se si duket kjo në bazë të katër elementeve: aktiviteteve dhe detyrave, grupimit të studentëve, materialeve dhe burimeve mësimore, dhe strukturës dhe ritmit.

Bisedat ku përdoret gjuhë më specifike bëjnë që mësimdhënësit ta analizojnë praktikën e tyre dhe që vëzhguesit të pyesin për vendimet që ka marrë një mësimdhënës në planifikimin dhe mbajtjen e orës mësimore.

Vëzhgues të shkathtë: Ata që i mbështesin mësimdhënësit, mentorët, mbikëqyrësit, etj., duhet të jenë në gjendje të dallojnë shembuj në klasë të komponenteve të ndryshme të praktikës dhe t'i angazhojnë mësimdhënësit në biseda produktive për praktikën e tyre. Mentorët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë informata të sakta kthyesë për mësimdhënësit në mënyrë që mësimdhënësit ta pranojnë atë si të vlefshëm.



Hattie, J.A.C, A synthesis of over 800 meta-analyses relating to achievement. London, Routledge. (2009)

Procesi i vëzhgimit të orës mësimore

Hapat kryesorë të një procesi të vëzhgimit të orës mësimore janë:

- Takimi para vëzhgimit
- Mbledhja e provave
- Interpretimi i provave
- Diskutimi pas vëzhgimit

4.1. Takimi para vëzhgimit

Qëllimi i takimit para vëzhgimit është që të identifikohen bashkërisht aspektet në të cilat mësimdhënësi do të donte që vëzhguesi të përqendrohej. Kjo gjithashtu mund të jetë një mundësi e mirë për t'i diskutuar objektivat profesionale me mësimdhënësit, nëse ato janë në hartimin e orës mësimore, mbajtjen e orës, zhvillimin profesional, ose nëse fokusohen në ndonjë standard tjetër.

Mësimdhënësit mund të diskutojnë me mentorin fushat të cilat dëshirojnë t'i përmirësojnë ose t'i zhvillojnë, planet e tyre të zbatimit dhe si do të vlerësojnë nëse i kanë përmbushur objektivat e tyre. Ata identifikojnë një aspekt të cilit dëshirojnë që mentori t'i kushtojë vëmendje gjatë vëzhgimit. Për shembull, mësimdhënësi mund të kërkojë nga mentori të vëzhgojë se si ajo ose ai u jep udhëzime nxënësve për një aktivitet dhe të shkruajë saktësisht se çfarë thotë dhe bën mësuesi kur jep udhëzime.

Disa nga pyetjet që mund të diskutohen gjatë takimit para vëzhgimit janë:

- Çfarë saktësisht do të dëshironit që unë të vëzhgoja?
- Pse konsideroni se vëzhgimi duhet të përqendrohet në këtë aspekt të caktuar? A keni marrë parasysh ndonjë nga format e tjera të vetëvlerësimit? (psh. vetë-reflektimi, mbledhja e perceptimeve të nxënësve ose prindërve, etj.)
- Ku do të dëshironit të fokusohet vëzhgimi? P.sh. Në llojet e pyetjeve që po përdorni?

Përfundimet e takimit para vëzhgimit duhet të shkruhen në pjesën e parë të shabllonit për vëzhgim të orës mësimore që mund të gjendet në Shtojcën 1.



4.2. Mbledhja e provave

Kur bëhet vëzhgimi në një klasë, vëzhguesit / mentorët duhet të shënojnë atë që shohin dhe dëgjojnë aty. Është e rëndësishme që ajo që ata shkruajnë të jenë prova - dhe jo opinion, interpretim ose paragjykim.

Provat mund të jenë në shumë forma, për shembull: fjalët e folura nga mësimdhënësi ose nxënësit, të tilla si, "A ka dikush ndonjë tjetër ide?"; veprime, të tilla si, "Nxënësve iu deshën 45 sekonda për t'u radhitur nga dera"; ose pamja e klasës, si p.sh., "muret nuk mirëmbahen". Provat mund të gjenden edhe në fletoret e studentëve - sa shpesh ka komentuar mësimdhënësi për punën e një nxënësi; apo nëse ka ndonjë provë në fletoren e punës së nxënësve për hulumtim të pavarur të të menduarit?

Por është e vështirë të regjistrohen vetëm prova. Praktikisht të gjithë mësimdhënësit pranojnë se përfshijnë disa interpretime ose mendime në shënimet e tyre. Për shembull, një vëzhgues mund të vërejtë se "nxënësit janë të angazhuar" në zgjidhjen e problemeve gjatë orës së matematikës, por kjo nuk mund të konsiderohet provë. Nuk është diçka që mësimdhënësi ose nxënësit e kanë bërë ose thënë. Përkundrazi, është një interpretim i asaj që vëzhguesi dëgjon dhe sheh. Ajo që vëzhguesi në të vërtetë mund të ketë parë është që nxënësit diskutojnë, me gjallëri, se si do të ishte problemi në jetën reale jashtë klasës, duke mësuar nga diskutimet e tyre me njëri-tjetrin, dhe duke vizatuar skica të modeleve të tyre në tabelë. Këto gjëra do të ishin provat, të cilat vëzhguesi i ka interpretuar si angazhim i nxënësve. Ky dallim është i rëndësishëm sepse kur vëzhguesit nuk pajtohen për cilësinë e performancës së një mësimdhënësi, është thelbësore të dihet nëse ndryshimet rrjedhin nga një ndryshim në provat e mbledhura ose në mënyrën se si vëzhguesi i ka interpretuar ato prova.

Një mjet praktik për vëzhgimin e orës mësimore mund të gjendet në Shtojcën 1.

4.3. Interpretimi i provave

Provat që një vëzhgues mund t'i mbledhë në klasë nuk janë në vetvete të mira apo të këqija. Ajo që çon në gjykimin në lidhje me cilësinë e mësimdhënies është interpretimi i provave ndaj kriterëve të vëzhgimit të orës mësimore ose niveleve të performancës. Pyetja për vëzhguesin nuk është çfarë ka ndodhur (kjo është prova), por cila është domethënia e asaj prove? Pra, cili grumbull i fjalëve në kriteret e vëzhgimit të orës mësimore përmbledh më së miri ose karakterizon atë që është vëzhguar?

Kjo pyetje është pjesa kryesore e trajnimit të vëzhguesve. Është thelbësore që individë të ndryshëm, duke përdorur të njëjtën kornizë, të bien dakord për nivelin e cilësisë së asaj që ata vëzhgojnë-d.m.th., që ata të zgjedhin të njëjtin nivel të performancës për atë që vëzhgojnë për të njëjtën arsye. Nëse nxënësit, me iniciativën e tyre, bëjnë bankat e tyre së bashku për të bërë grupe dhe i mbledhin materialet e nevojshme, veprimet e tyre do të ofronin prova për praktikë kreative ose praktikë të nivelit të lartë nga ana e mësimdhënësit sepse mësimdhënësi vet i ka krijuar këto rutina dhe i ka mësuar nxënësit që t'i ndjekin ato rutina.

Pikëpamjet e mentorit lidhur me provat e mbledhura mund të regjistrohen në shabllonin e takimit pas vëzhgimit (shiko Shtojcën 2).

Shihni më shumë detaje mbi procesin e vlerësimit formativ në Udhëzuesin për krijimin e mekanizmit me bazë në shkollë për identifikimin e nevojave për ZHPM

4.4. Takimi pas vëzhgimit

Ajo që ndodh gjatë procesit të informatave kthyesë është thelbësore për zhvillimin e mësimdhënësve. Qëllimi i diskutimit pas vëzhgimit është që të diskutohet me mësimdhënësin në lidhje me pikat e forta dhe pikat në të cilat duhet zhvillim i mëtutjeshëm për t'i arritur përmirësimet që nevojiten. Informatat kthyesë lidhur me atë që është bërë mirë dhe çfarë mund të bëhet ndryshe duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të dobishme dhe specifike.

Gjithashtu, e rëndësishme për ndikimin në zhvillimin e mësimdhënësve është kredibiliteti i mentorit, aftësia e tij / saj për të dhënë sugjerime dhe niveli i besimit. Siç u përmend më herët, përqendrimi i vlerësimit në standarde të qarta që miratohen nga mësimdhënësi ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e mësimdhënësve.

Shumë vëzhgues, edhe në raste kur janë të trajnuar në mënyrë adekuate për të kryer vëzhgime në klasë, pajtohen që natyra, përmbajtja dhe detajet e informatave kthyesë ndaj mësimdhënësve pas një vëzhgimi mund të jenë mjaft të vështira për t'u hartuar. Është e qartë se ekziston një rol për informata kthyesë, si p.sh. në "E vërejtja se i keni bërë dy të tretat e pyetjeve tuaja për nxënësit në anën e djathtë të klasës. A ishit në dijeni për këtë?" Por përqendrimi më i madh i një bisede pas orës mësimore duhet të jetë dialogu, ku bëhet ndarja e pikëpamjeve dhe perspektivave.

Në vend që të jetë si mundësi që vëzhguesi thjesht t'i tregojë mësimdhënësit se çfarë mendon për orën mësimore ("Mua me të vërtetë më pëlqeu mënyra se si e bërë këtë ose atë gjë"), bisedat pas vëzhgimit janë mundësia më e mirë për t'i bërë mësimdhënësit të mendojnë se si mund ta forcojnë praktikën e tyre të mësimdhënies. Temat dhe pyetjet që diskutohen në takimin pas vëzhgimit mund të përfshijnë si në vijim:

- **Si mendoni se shkoi ora mësimore?**
- **Çfarë ju pëlqeu?**
- **Në cilin aspekt mendoni se duhet të punohet më shumë?**
- **A ka ndonjë gjë që do të donit të bëhej ndryshe herën tjetër?**
- **Çfarë veprimesh do të ndërmerri tani?**
- **Kur do të dëshironit që të vëzhgoja përsëri orët tuaja mësimore?**



Vëzhgimi ndërmjet kolegëve

Vëzhgimi ndërmjet kolegëve ka të bëjë me ndihmën që mesimdhënësit i ofrojnë njëri-tjetrit. Ashtu si në rastin e vëzhgimit nga mentori, kjo mund të bëhet duke u përqëndruar në një ose dy aspekte të planeve mesimore të mesimdhënësve, mbajtjes së orës mesimore ose ambientit në klasë, duke diskutuar se si duket dhe si do të mund të dukej më ndryshe. Njësoj si në rastin e vëzhgimit nga mentori, nuk ka të bëjë me vlerësimin, gjykimin ose klasifikimin, sepse kur mesimdhënësit nxiten ta vlerësojnë njëri-tjetrin, kjo mund ta zvogëlojë besimin dhe t'i dëmtojë marrëdhëniet midis kolegëve.

Mentori për vëzhgim ndërmjet kolegëve mund të zgjidhet midis anëtarëve të Ekipit të Shkollës për Zhvillim Profesional. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se vëzhgimi ndërmjet kolegëve ka për qëllim t'i përmirësojë metodat dhe aftësitë e mesimdhënies, shkollat mund të lejojnë që mesimdhënësit të bashkohen vullnetarisht për të vëzhguar orët mesimore të njëri-tjetrit dhe të jenë vlerësuesit e kolegëve të tyre. Roli i mentorit të ZHPM me bazë në shkollë në lehtësimin e këtij procesi është kyç, e sidomos në:

- Inkurajimin e mesimdhënësve që të kërkojnë vëzhgim nga mentori / kolegët,
- Identifikimin e kolegut vëzhgues- procesi i grupimit, bazuar në nevojat dhe pikat e forta të mesimdhënësve individual,



- Trajnimin / përgatitjen e kolegëve vëzhguesë për ta zhvilluar siç duhet procesin e vëzhgimit. Beddes et al. (2012) hartuan dhe prezantuan një model për mentorimin ndërmjet kolegëve duke u bazuar në punën e Huston dhe Weaver (2008) si dhe informatat nga Fakulteti për Reforma Kombëtare Shkollore.

Ata e përdorin metodën e mëposhtme për mentorim ndërmjet kolegëve. Së pari, mësimitdhënësit identifikojnë një partner për mentorim të ndërsjellë. Ata bien dakord që t'i ndajnë për njëri-tjetritin tre orë të kohës së tyre gjatë një periudhe: 30 minuta për një bisedë para vëzhgimit, një orë vëzhgim të fokusuar (reciprok) dhe një diskutim pas vëzhgimit prej 30 minutash.

Gjatë diskutimit 30 minutësh para vëzhgimit të dy mësimitdhënësit identifikojnë aspektin në të cilin do të fokusohet vëzhgimi i tyre dhe i caktojnë rregulla themelore siç është vendi ku vëzhguesi do të ulet. Secili mësimitdhënësi vëzhgon tjetritin për një orë ose më shumë duke u fokusuar vetëm në aspektin e identifikuar dhe merr shënime.

Vëzhguesi gjithashtu mund të reflektojë dhe të japë ide ose sugjerime nëse mësimitdhënësi tjetër dëshiron të marrë informata kthyesë shtesë. Mësimitdhënësit takohen përsëri për diskutim 30-minutësh pas vëzhgimit për t'i treguar shënimet, për të diskutuar atë që është vërejtur dhe për të shkëmbyer sugjerime.

Një shqetësim i zakonshëm për vëzhgimin ndërmjet kolegëve është koha që shpenzohet gjatë këtij procesi. Sidoqoftë, tre orë gjatë një periudhe nuk konsiderohet se mund të jenë të lodhshme. Vidmar (2006) sugjeron se meqenëse mësimitdhënësit zgjedhin kolegun me të cilin dëshirojnë të punojnë, ata mund të zgjedhin dikë, orari i të cilit përshtatet mirë me orarin e vet, dhe se takimet para dhe pas vëzhgimit mund të konsiderohen si një pushim kafeje së bashku.



Dokumente dhe linqe për materiale

Shtojca 1: Rast studimor – Përvoja e një ekipi mësuesish ‘të detyruar’ të marrin pjesë në mentorim grupor të kolegëve në një shkollë të mesme suedeze

Emri i vëzhguesit		Data:
Vendi i vëzhgimit	Qyteti/ Qendra e Qarkut /Qarku	Shkolla:
Emri i mësimeve	Përvojë mësimore: më pak se 5 vjet <input type="checkbox"/> më shumë se 5 vjet <input type="checkbox"/>	
Tema		Klasa:

Formulari i Vëzhgimit të Mësimi

Komponentët e vëzhgimit	Nivelet			Komentet
	1	2	3	
Menaxhimi në klasë dhe mjedisi psikologjik				
1. Organizimi i hapësirës në klasë				
2. Niveli i angazhimit të nxënësve				
3. Strategjitë e menaxhimit në klasë				
4. Atmosfera në klasë				
Mjedisi mësimor dhe metodat e mësimdhënies				
5. Vendosja e objektivave mësimore				
6. Vendosja e detyrave të mësimi				
7. Orientimi i detyrave të mësimi dhe metodave të mësimdhënies				
9. Njohja e përmbajtjes dhe përdorimi i gjuhës				
10. Lidhja e mësimi me jetën e përditshme				
11. Pyetje dhe përgjigje				
Vlerësimi				
12. Kriteret e vlerësimi				
13. Strategjia e Vlerësimi				
14. Përdorimi i vlerësimi si pjesë e mësimdhënies / mësimi				
15. Angazhimi i nxënësve në vlerësim				
Rezultati i përgjithshëm	15	30	45	

Pikët më të ulëta dhe më të larta: Minimumi-15; Maksimumi-45

Shpërndarja e pikëve sipas niveleve: E dobët: 15-24; Mesatare: 25-33; E lartë: 34-45

Kriteret e vëzhgimit të mësimit

Komponentët	Niveli fillestar / i dobët	Niveli mesatar
	Menaxhimi në klasë dhe mjedisi psikologjik	
Organizimi i hapësirës në klasë	<input type="checkbox"/> Hapësira e klasës nuk ndryshon në varësi të formave dhe llojeve të aktiviteteve të te mësuarit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ndonjëherë organizon hapësirën në klasë në përputhje me format dhe llojet e aktiviteteve të te mësuarit
Niveli i angazhimit të nxënësve	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi është në qendër të mësimit; transmetimi i informacionit në formë të ligjëratës merr 70-80% të mësimit; angazhimi i nxënësve është monoton (leximi, ritregimi, regjistrimi etj) <input type="checkbox"/> Mësimdhënësi angazhohet / bashkëvepron me një grup të vogël nxënësish (me arritje më të lartë, studentë aktivë, më shumë me djemtë sesa me vajzat etj)	<input type="checkbox"/> Studentët nganjëherë punojnë në çifte ose grupe të vogla, rrallë komentojnë / plotësojnë përgjigjet dhe mendimet e njëri-tjetrit; angazhimi i nxënësve në mësimin aktiv përbën 30-50% të mësimit <input type="checkbox"/> Mësuesi angazhohet / ndër-vepron me shumicën e studentëve
Strategjitë e menaxhimit në klasë	<input type="checkbox"/> Menaxhimi në klasë është një mënyrë nga mësimdhënësi tek nxënësit	<input type="checkbox"/> Menaxhimi në klasë është një mënyrë nga mësimdhënësi tek nxënësit me disa elemente të vetë-organizimit dhe vetë-menaxhimit të nxënësve
	<input type="checkbox"/> Rregullat, standardet e sjelljes përdoren për vendosjen e disiplinës dhe kontrollit mbi studentët	<input type="checkbox"/> Rregullat, standardet e sjelljes përdoren për vendosjen e disiplinës; disa rregulla përdoren për të kryer diskutime dhe punë në grupe
	<input type="checkbox"/> Në rast të sjelljes së gabuar, mësimdhënësit tallen, shajnë, fyen studentët dhe përdorin ndëshkime fizike	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi reagon ndaj sjelljes së keqe; nganjëherë ngre zërin e tij, por në përgjithësi e mban qetësinë dhe i shmang studentët ofendues
Atmosfera në klasë	<input type="checkbox"/> Një atmosferë negative psikologjike dominon mësimin (shumica e nxënësve janë pasiv, kanë frikë për të shprehur mosmarrëveshje, rrallë bëjnë pyetje dhe ndihen të paretatshëm me mësimdhënësin)	<input type="checkbox"/> Shumica e nxënësve ndjehen rehat me mësuesin; mësuesi tregon respekt ndaj studentëve; Atmosfera psikologjike është miqësore me ndërveprimin dhe aktivitetet e të mësuarit
Mjedisi mësimor dhe metodat e mësimdhënies		
Vendosja e objektivave mësimore	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi shpall temën, por nuk shpjegon objektivat e mësimit <input type="checkbox"/> Shumica e studentëve nuk janë të interesuar në temën e mësimit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi shpall qëllimet kryesore të mësimit në përgjithësi, por fokusohet më shumë në aktivitetet e planifikuara, si rezultat i të cilave studentët nuk i kuptojnë plotësisht rezultatet e të mësuarit (çfarë do të jenë në gjendje të njohin, të kuptojnë dhe të bëjnë deri në fund të mësimit) <input type="checkbox"/> Një pjesë e studentëve janë të interesuar për temën e mësimit

Kriteret e vëzhgimit të mësimit

Komponentët	Niveli kreativ / i lartë
	Menaxhimi në klasë dhe mjedisi psikologjik
Organizimi i hapësirës në klasë	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi organizon me kompetencë hapësirën në klasë në përputhje me format dhe llojet e aktiviteteve të të mësuarit
Niveli i angazhimit të nxënësve	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi në mënyrë efektive e menaxhon klasën me forma të ndryshme të ndërveprimit të nxënësve (palë, grup, pune individuale); shpesh përcjell komentet / idetë e një studenti tek tjetri ose e një grup tek tjetri; angazhimi i nxënësve në mësimin aktiv përbën 70-80% të mësimit <input type="checkbox"/> Mësimdhënësi angazhohet / bashkohet me të gjithë nxënësit pavarësisht nga gjinia e tyre, niveli i arritjeve, statusi socio-ekonomik dhe dallimet e tjera.
Strategjitë e menaxhimit në klasë	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi delegon një pjesë të menaxhimit të klasës tek studentët; krijon mundësi për zhvillimin e vetë-organizimit dhe aftësive të vetë-menaxhimit të nxënësve
	<input type="checkbox"/> Nxënësit marrin pjesë në zhvillimin e rregullave standardeve të sjelljes dhe sigurohen që ato të ndiqen <input type="checkbox"/> Rregullat janë të drejtuara në ndjekjen e normave të kulturës së marrëdhënieve të ndërsjella (duke zhvilluar diskutime dhe aktivitete të përbashkëta)
	<input type="checkbox"/> Mësuesi toleron sjellje të këqija të vogla; <input type="checkbox"/> Mësuesi përdor forma psikologjike të komentimit në mënyrë paqësore
Atmosfera në klasë	<input type="checkbox"/> Një atmosferë mbështetëse psikologjike inkurajon iniciativën, aktivitetin njohës të nxënësve; krijon kushte për hapjen dhe besimin emocional
Mjedisi mësimor dhe metodat e mësimdhënies	
Vendosja e objektivave mësimore	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi u siguron nxënësve kuptim të qartë të objektivave mësimore; studentët kuptojnë qartë rezultatet e mësimit <input type="checkbox"/> Mënyra se si përcaktohen objektivat e mësimit, mundëson që shumica e studentëve të interesohen për temën e mësimit

Komponentët	Niveli fillestar / i dobët	Niveli mesatar
	Mjedisi mësimor dhe metodat e mësimdhënies	
Vendosja e detyrave të mëimit	<input type="checkbox"/> Mësuesi shpjegon detyrat e mëimit, por nuk përpiqet për të marrë reagime (çfarë dhe se si kuptojnë studentët)	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi shpjegon detyrat e mëimit dhe përpiqet të marrë informacione kthyesë)
Orientimi i detyrave të mëimit dhe metodave të mësimdhënies	<input type="checkbox"/> Mësuesi përdor metoda tradicionale të mësimdhënies (shpjeguese dhe riprodhuese) <input type="checkbox"/> Kryesisht përdoren detyra riprodhuese të mësuarit ("Lexo", "Ritregoni", "Përsërit", "Kujtoj") pa marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve	<input type="checkbox"/> Mësuesi në mënyrë të barabartë përdor metoda riprodhuese dhe aktive të mëimit <input type="checkbox"/> Përdoren detyrave të te mësuarit pothuajse proporcionale të riprodhimit dhe në bazë të hulumtimit ("Testo", "Shpjego", "Vlerëso", "Krahaso") duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve
Përdorimi i mjeteve arsimore dhe materialeve mësimore	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi përdor vetëm një burim informacioni - tekstin <input type="checkbox"/> Ndihma / materialet vizuale dhe didaktike ose nuk përdoren fare ose përdoren në mënyrë të kufizuar <input type="checkbox"/> Mjetet teknike të te mësuarit (MTM) dhe TI nuk përdoren fare ose përdoren në mënyrë joefektive	<input type="checkbox"/> Mësuesi ndonjëherë ofron një burim tjetër informacioni përveç tekstit shkollor <input type="checkbox"/> Ndihma / materialet vizuale dhe didaktike nuk përdoren gjithmonë në mënyrë efektive <input type="checkbox"/> Mjetet teknike të te mësuarit (MTM) dhe TI nuk përdoren gjithmonë në mënyrë efektive
Njohja e përmbajtjes dhe përdorimi i gjuhës	<input type="checkbox"/> Mësuesi i njeh komponentët kryesorë të përmbajtjes së lëndës, përqendrohet kryesisht në tekstin shkollor, fjalimi i tij / saj nuk është figurativ apo i pasur me shembuj	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ka njohuri të mira për lëndën, sjell shembuj shtesë, shpreh informacionin shkencor në një formë të qasshme për studentët
Lidhja e mëimit me jetën e përditshme	<input type="checkbox"/> Mësuesi praktikisht nuk përpiqet të lidhë përmbajtjen e mëimit me jetën e përditshme (përdorimi praktik i njohurive në jetë)	<input type="checkbox"/> Mësuesi ndonjëherë përpiqet të përdorë disa strategji në mënyrë që të ndihmojë studentët të lidhin informacion të ri me jetën e tyre të përditshme
Pyetje dhe përgjigje	<input type="checkbox"/> Mësuesi kryesisht pyet pyetje për të kontrolluar memorizimin dhe i kushton vëmendje përgjigjeve që janë formale korrekte (riprodhimi i informacionit faktik). <input type="checkbox"/> Mësuesi nuk u jep studentëve kohë për të menduar, në rast se nuk janë në gjendje të përgjigjen menjëherë <input type="checkbox"/> Mësuesi shpesh ndërpret studentët në vend që të presë deri sa të përfundojnë	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi parashtron pyetje për të kontrolluar dijen dhe mirëkuptimin; rrallë pyet pyetje të hapura <input type="checkbox"/> Mësuesi ndonjëherë ndan kohë për të menduar për ata studentë të cilët nuk mund t'u përgjigjen menjëherë pyetjeve <input type="checkbox"/> Mësuesi ndonjëherë u jep nxënësve një mundësi për të përfunduar përgjigjet e tyre

Niveli kreativ / i lartë	
Mjedisi mësimor dhe metodat e mësimdhënies	
Vendosja e detyrave të mësimimit	<input type="checkbox"/> Mësuesi shpjegon detyrat dhe merr reagime; vëzhgon procesin e realizimit të detyrës dhe, nëse është e nevojshme, bën korrigjime
Orientimi i detyrave të mësimimit dhe metodave të mësimdhënies	<input type="checkbox"/> Mësuesi përdor metoda efektive të mësimimit aktiv dhe inter-aktiv <input type="checkbox"/> Dominimi i jepet kreativitetit, problemeve dhe detyrave të mësimimit bazuar në hulumtim, duke u mbështetur në përvojën e studentëve dhe duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve
Përdorimi i mjeteve arsimore dhe materialeve mësimore	<input type="checkbox"/> Mësuesi shpesh ofron burime shtesë informacioni <input type="checkbox"/> Materialet e ndryshme vizuale dhe didaktike përdoren në mënyrë kreative <input type="checkbox"/> Mjetet teknike të të mësuarit (MTM) dhe IT përdoren në mënyrë efektive <input type="checkbox"/> Inkurajon studentët që të kërkojnë informacion duke përdorur IT <input type="checkbox"/> Motivon studentët për të zgjidhur dhe vlerësuar informacionin e dhënë; gjenerojnë njohuri të reja dhe e pasqyrojnë atë në forma sistematike, me shkrim dhe verbale
Njohja e përmbajtjes dhe përdorimi i gjuhës	<input type="checkbox"/> Mësuesi bazohet mirë në njohjen e përmbajtjes së temës; jep shembuj të ndryshëm interesantë dhe informacione shkencore; fjalimi i mësuesit është i ushqyer intelektualisht dhe emocionalisht; nxit mirëkuptimin njohës të nxënësve
Lidhja e mësimimit me jetën e përditshme	<input type="checkbox"/> Mësuesi përdor qasje dhe strategji logjike që u mundëson studentëve të përdorin njohuritë e tyre për zgjidhjen e problemeve që lidhen me jetën e tyre reale (njohuritë funksionale / praktike)
Pyetje dhe përgjigje	<input type="checkbox"/> Mësuesi përdor pyetje në lidhje me të gjitha nivelet e taksonomisë së Bloom-it, shumica e të cilave janë pyetje të hapura <input type="checkbox"/> Mësuesi i ndan kohë studentëve që të mendojnë për përgjigjet e tyre <input type="checkbox"/> Nëse një student nuk është në gjendje të përgjigjet menjëherë, mësuesi përcjell pyetjen tek studentët e tjerë dhe i lejon atij / asaj të përgjigjet përsëri, më vonë <input type="checkbox"/> Mësuesi gjithmonë i lejon nxënësit të përfundojnë përgjigjet e tyre <input type="checkbox"/> Mësuesi në mënyrë efektive përdor teknikat e marrjes në pyetje të kolegëve, i mëson dhe i inkurajon ata që të kërkojnë pyetje në shumë nivele

Vlerësim		
Kriteret e vlerësimit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi nuk ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e kompetencave specifike të lëndëve / nxënësve	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ka një kuptim të përgjithshëm se si të vlerësojnë kompetencat specifike të lëndëve / aftësitë e nxënësve
Strategjia e Vlerësimit	<input type="checkbox"/> Nxënësit informohen rrallë për kriteret e vlerësimit	<input type="checkbox"/> Nxënësit janë të informuar nganjëherë për kriteret e vlerësimit dhe diskutojnë me mësuesin
	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi vlerëson njohuritë faktike duke përdorur pyetje, teste dhe forma të tjera të vlerësimit përmbledhës	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi vlerëson njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë e aplikimit të njohurive duke përdorur pyetje, teste, vëzhgime etj.
	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi nuk ofron mundësi për studentët që të përmirësojnë notat e tyre	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ndonjëherë ofron mundësi për studentët që të përmirësojnë notat e tyre
Përdorimi i vlerësimit si pjesë e mësimdhënies/ mësimit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi nuk përpiqet të marrë dhe të japë reagime për studentët; rrallë sjell ndryshime në mësim	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ndonjëherë përdor reagime dhe paraqet ndryshime në mësim
Angazhimi i nxënësve në vlerësim	<input type="checkbox"/> Vlerësimi kryhet ekskluzivisht nga mësimdhënësi	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi përfshin disa studentë në procesin e vlerësimit (ata ndihmojnë mësuesin të kontrollojë punën e shokëve të tyre të klasës)

Kriteret e vlerësimit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi ka kriteret e qarta për kompetencat e lëndëve / vlerësimin e aftësive të nxënësve	
Strategjia e Vlerësimit	<input type="checkbox"/> Nxënësit informohen për kriteret e vlerësimit dhe diskutojnë me mësuesin (para se të bëjnë detyrat) Kriteret e vlerësimit mund të ndryshojnë në bazë të opinionëve të studentëve (diskutime dhe marrëveshje)	
	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi përdor mjete të ndryshme të vlerësimit të kompetencave specifike të lëndëve; monitoron ndryshimet në kuptimin dhe aftësitë e nxënësve	
	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi rregullisht ofron mundësi dhe motivon studentët që të përmirësojnë notat e tyre fillestare	
Përdorimi i vlerësimit si pjesë e mësimdhënies / mësimit	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi në mënyrë efektive përdor vlerësimin / reagimet formative; tregon fleksibilitet dhe rregullon aktivitetet e të mësuarit gjatë gjithë fazave të mësimit në kohën e duhur.	
Angazhimi i nxënësve në vlerësim	<input type="checkbox"/> Mësimdhënësi përfshin studentët në procesin e vlerësimit, zhvillon aftësitë e tyre të vetëvlerësimit	

Shtojca 2: Përmbledhje e diskutimit pas vëzhgimit

Data e takimit: _____ Mësimdhënësi: _____
Data e vëzhgimit: _____ Vëzhguesi: _____
Komponenti i vëzhguar: _____
Fokusi i vëzhgimit: _____

Shënimet e vëzhguesit	Pikëpamjet e mësimdhënësve
Përparësitë:	Përparësitë:
Fushat për përmirësim:	Fushat për përmirësim:
Veprimet vijuese:	



European
Union
Kosovo

Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi ekskluzive e konsorciumit zbatues dhe
nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

